

Urdhër Nr 130 Prot.  
dt. 3/4/06



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE  
MINISTRI

---

## URDHËR

Nr 114, Datë 20 / 03 / 2006

### PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE

Drejtuar : **GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE**

**DREJTORISË SË TRASHËGIMISË KULTURORE**

Duke marrë parasysh detyrimin ligjor të nenit 5 dhe 23 të ligjit Nr. 9386, dt. 4.05.2005 "Për muzetë", konstatova se është në kompetencë të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, rishikimi dhe miratimi i statutit të Galerisë Kombëtare të Arteve, institucion muzeor kombëtar në varësi të MTKRS.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenve 5, pika 3 dhe nenit 23, pika 2 të ligjit Nr. 9386, dt. 4.05.2005 "Për muzetë",

### URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Galerisë Kombëtare e Arteve, që i bashkëlidhet këtij Urdhëri.
2. Ngarkohet Galeria Kombëtare e Arteve për zbatimin e këtij Urdhëri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore për njoftimin e këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

*Bujar Leskaj*

BUJAR LESKAJ





## STATUTI

### I

## GALERISE KOMBETARE TE ARTEVE

### Kapitulli I

#### DISPOZITA TË PERGJITHSHME

##### Pika 1

Galeria Kombetare e Arteve (GKA), është institucion qëndror, muzeor, studimor, shkencor, promovues, në varesi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinise dhe Sporteve, i pamvarur nga partitë, shoqatat politike, institucionet apo organizatat fetare. GKA është person juridik publik, që nuk ndjek qëllime ekonomike. Ajo e ka selinë në Bulevardin Deshmorët e Kombit, Tiranë, ka vulën dhe emblemën e saj.

##### Pika 2

Galeria Kombëtare e Arteve, është institucion kombëtar, i cili koleksionon, konservon, dokumenton, ekspozon dhe interpreton materialin pamor të koleksionit, duke dhënë informacion lidhur me të, me qëllim përfitimi public, në përshtatje me drejtimit dhe politikën kulturore europiane në art, identitet, shumëllojshmëri, krijimtari dhe pjesëmarrje.


Ky institucion e zhvillon veprimtarinë e tij për të ruajtur dhe prezantuar trashëgiminë dhe të tashmen në fushën e arteve pamore.

GKA në veprimtarinë e saj, zbaton politiken e MTKRS në fushën e arteve pamore duke hulumtuar në fushën e ekspozimit, propagandimit, studimit, mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, duke promovuar vlerat me të mira të artit shqiptar të traditës dhe atij bashkohor kombëtar dhe nderkombëtar të mbështetur në teknologji moderne.

### Kapitulli II

#### PARIMET DHE FUNKSIONI

##### Pika 3



Veprimtaria e GKA mbështetet në Ligjin Nr 9048 dt 7.4.2003, "Për trashëgimë kulturore" dhe në Ligjin Nr. 9386, dt.04.05.2005, "Për muzetë", në këtë statut, dhe në rregulloren e brendëshme si edhe rregullat në fuqi.

Marrdheniet juridike në punë të punonjesve të GKA rregullohen në baze të ligjit Nr 7961 dt 12.07.1995, "Për Kodin e punës", si edhe ndryshimet përkatëse në Ligjin nr.9125, datë 29.07.2003.

#### Pika 4

GKA bashkëpunon me institucione muzeore, artistike, kulturore, shkencore si dhe persona private apo juridike për evidentimin, regjistrimin, grumbullimin, restaurimin e veprave të artit objekt i trashëgimise kulturore ose jo, në fushën e arteve pamore.

#### Pika 5

GKA bashkëpunon me organet e administratës shtetërore qendrore, me organe të qeverisjes vendore si dhe me institucione artistike kulturore shkencore, shtetërore apo private, brenda dhe jashtë vendit, për të terhequr vepra me vlera të vecanta si dhe për ekspozita dhe aktivitete të përbashkëta.

#### Pika 6


GKA organizon brenda dhe jashtë vendit çeljen e ekspozitave me vepra të fondit të saj, në përputhje me rregullat e shtetit shqiptar. Krahas ekspozimit të koleksionit kombëtar, Galeria Kombëtare e Arteve, organizon edhe ekspozita, të cilat nuk bien ndesh me misionin e saj.

#### Pika 7

Hyrja në fondin e GKA-së për qëllime studimi apo kontrolli bëhet kurdoherë ve tëm me lejen e drejtorit të institucionit pas kërkesës me shkrim nga subjekti kerkues.

#### Pika 8

Filmimi dhe fotografimi i veprave, pjesë e inventarit të fondit të GKA për qëllime studimi, botimi apo për qëllime të tjera, bëhet vetëm me lejen e



Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinise dhe Sporteve , bazuar në Ligjin“ Per trashëgimime kulturore”Nr 9048,dt 7.04.2003, Neni 16, pika 2 dhe të Ligjit Nr. 9386, dt.04.05.2005, “Për muzetë”

Filmimi apo fotografimi behet pas nënshkrimit të kontratës dypalëshe dhe pagese se tarifës se caktuar per kete rast

#### **Pika 9**

GKA bashkëpunon dhe krijon lidhje me institucione homologe ose organizma të tjera në vende të ndryshme të botes për të bërë të njohur artin dhe kulturën shqiptare.

#### **Pika 10**

Për promovimin e vlerave të artit pamor shqiptar GKA boton periodikë, studime , monografi ,kataloge ,albume, guida.

#### **Pika 11**

GKA është qendër metodike trajnimi. Aty organizohen seminare, takime pune për kualifikimin e punonjësve të sistemit të galerive të vendit dhe të institucioneve të tjera kulturore, shoqatave grupeve dhe individëve që janë të interesuar në fushën e menaxhimit të arteve pamore.

#### **Pika 12**

Për realizimin e funksioneve të saj, GKA bashkëpunon me institucione të specializuara si Instituti i Monumenteve të Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Muzeumet Kombëtare, Akademinë e Shkencave.

Gjithashtu GKA bashkëpunon me “Miq të Galerisë” dhe “Bordin e Nderit”, që janë organizata joqeveritare dhe që ndihmojnë në financimet për realizimin e veprimtarisë së saj muzeore, artistike et.

#### **Pika 13**

GKA, kryen restaurime të objekteve të fondit të saj, apo edhe restaurime veprash arti, pjesë e fondit të institucioneve në varësi të MTKRS dhe Akademisë së Shkencave. Restaurimi i objekteve që nuk bëjnë pjesë në fondin e GKA, kryhet pas nënshkrimit të marrëveshjes së për këtë rast.



Restaurimi në çdo rast kryhet pas miratimit të projektit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

### KAPITULLI III

#### STRUKTURA ORGANIZATIVE

##### **Pika 14**

Struktura dhe organika e GKA propozohet nga ministri dhe miratohet me urdher të Kryeministrit në përputhje me ligjin 9386, dt. 04.05.2005, "Për muzetë".

##### **Pika 15**

Drejtori i GKA emrohet dhe shkarkohet nga Ministri i Turizmit, Kultures Rinise dhe Sporteve sipas procedurave të percaktuara në VKM Nr 173 dt 7.3.2003.

Ai drejton dhe koordinon punën në të gjithë sektoret në përberje të GKA si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tjerët.

Drejtori është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit Shkencor të GKA

Drejtori emrohet në këtë detyrë vetëm për një mandat 5 vjeçar.

##### **Pika 16**

N/drejtori i GKA drejton punën administrative, menaxhuese dhe veprimtarinë ekonomike të institucionit

Ai emrohet dhe shkarkohet nga Ministri i Turizmit, Kultures Rinise dhe Sporteve me propozim të drejtorit të GKA.

##### **Pika 17**

Drejtori emron dhe shkarkon të gjithë punonjësit e tij në bazë të kodit të punës dhe rregullores së brendshme të GKA.

Drejtori lidh kontrata pune kolektive apo individuale me punonjësit, bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

##### **Pika 18**

Punonjesit jane te organizuar ne sektore, te cilet drejtohen nga pergjegjesit e tyre .Te drejttat dhe detyrat e pergjegjësave të sektorëve dhe te punonjesve qe varen prej tyre percaktohen ne rregulloren e brendshme te GKA, e cila miratohet nga drejtori i institucionit.

Rregullorja hartoet dhe miratohet njëmuaj pas hyrjes në fuqi të këtij statuti.

## **Pika 19**

Prane GKA funksionon Keshilli Shkencor-artistik si organ jofunksional, vendimarrës dhe komisionet e vleresimit te veprave te artit dhe të restaurimit.

Keshilli Shkencor-artistik perbehet nga 7 anëtarë, personalitete të kulturës dhe artit.

Keshilli Shkencor-artistik udheheq veprimtarine ekspozuese, muzeore, studimore, konservuse, restauruese, si dhe proceset e mundshme te rikonceptimit te sallave te ekspozimit te fondit te GKA dhe ekspozitat jo permanente me të tretë.

Këshilli Shkencor shqyrton dhe miraton kalendarin vjetor të aktiviteteve dhe projekteve.

Si rregull Keshilli mblidhet nje here ne dy muaj, ne 10 ditshin e pare. Ai thirret nga kryetari. Kryetari dhe anëtarët e KSH shperblehen për çdo mbledhje sipas rregullave në fuqi.

Keshilli Shkencor-artistik zgjidhet nje here ne 2 vjet. Anëtarët e këshillit propozohen nga drejtori i GKA dhe miratohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Këshilli Shkencor-artistik e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në këtë statut dhe rregulloren e tij e cila miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve një muaj pas datës së aprovimit të këtij statuti.

Keshilli Shkencor mund te zevendesoje anetaret e tij me kerkesën e tyre dhe me miratimin e Ministrit të Turizmit, Kultures Rinise dhe Sporteve

## **KAPITULLI IV**

### **ORGANIZIMI FINANCIAR**

## **Pika 20**

GKA është institucion buxhetor. GKA mund të marrë donacione dhe sponsorizime nga institucione apo organizata të ligjshme joshjteterore, bazuar rregullave në fuqi.

#### **Pika 21**

GKA paraqet në MTKRS çdo 30 qershor, programin e veprimtarive dhe te investimeve për vitin e ardhshëm të shoqëruar me preventivat përkatëse.

Plani i veprimtarive dhe i investimeve detyrimisht do të diskutohet dhe do të marrë miratimin me shkrim të Këshillit Shkencor-artistik.

Në çdo fundvit, GKA boton raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit. Ky raport bëhet public dhe është dokument bazë për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit.

### **KAPITULLI V**

#### **NDRYSHIME NË STATUT**

#### **Pika 22**

Statuti i GKA, miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë statut sygjërohen nga Këshilli Shkencor dhe miratohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Tiranë, 20/03/ 2006





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 98, Datë 03/03/2010

PËR

"NJË NDRYSHIM NË STATUTIN E GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE"

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës si dhe të pikës 22 të Statutit të Galerisë Kombëtare dhe 128 të Ligjit nr. 8485 dt. 12/5/1999, Kodi i Procedurave Administrative, me propozim të Këshillit Shkencor të Galerisë Kombëtare të Arteve

URDHËROJ:

1. Paragrafi 2, pika 19, kapitulli III ndryshohet si më poshtë:

*"Këshilli Shkencor- Artistik përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, personalitete të kulturës dhe artit"*

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhëri dhe GKA për zbatimin e tij.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FERDINAND VHAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE  
MINISTRI

URDHER

Nr. 513, Datë 27/12/2010

“PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 114, DATË 20.03.2006 “PËR MIRATIMIN E  
STATUTIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE””

Në mbështetje të Nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe pikës 3, të nenit 5 të ligjit nr. 9386, datë 4.05.2005 “Për Muzetë”;

URDHËROJ:

Në pikën 9 të Statutit të Galerisë Kombëtare të Arteve pjesë e urdhrit bëhet ndryshimi si më poshtë:

*“GKA bashkëpunon dhe krijon lidhje me institucione homologe ose organizma të tjera në vende të ndryshme të botës për të bërë të njohur artin dhe kulturën shqiptare.*

*Në çdo organizim ndërkombëtar (ekspozitë, pavion, panair etj) në fushën e artit pamor, ku shteti shteti shqiptar është pjesëmarrës, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, miraton përfaqësuesit (kurator, komisionerë, artistë etj) me propozim të Galerisë Kombëtare të Arteve ”*

2. Ngarkohet Galeria Kombëtare e Arteve për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria Artit për komunikimin e këtij Urdhri

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

